



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:137504
Datë: 20.05.2024
Numri i dokumentit: 05708951

Ac.nr.2834/23

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin e përberë nga gjyqtarët: Liridon Maloku, kryetar i kolegjit, Nora Bllaca-Dula dhe Malsor Kryeziu, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit H.G, të cilin e përfaqëson Av. N.K, kundër të paditurës Komuna e Malishevës- Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare “Shpëtim Robaj” në Malishevë, për kompensimin e shpërblimit jubilar, duke vendosur sipas ankesës së të autorizuarit të paditësit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë–Dega në Malishevë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.77/20, të datës 09.12.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 17.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

HEDHET si e pa afatshme ankesa e të autorizuarit të paditësit H.G, e ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë–Dega në Malishevë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.77/20, të datës 09.12.2022.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin e atakuar, C.nr.77/20, të datës 09.12.2022, ka vendosur si vijon: I. Gjykata Themelore Gjakovë - Dega në Malishevë SHPALLET IN KOMPETENTE në pikëpamje Lëndore, për të vendosur në këtë çështje juridiko–kontestimore. II.Pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi, shkresat e kësaj lëndë do ti dërgohen Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, pasi që është gjykatë kompetente.

Kundër këtij aktvendimi ankesë ka paraqitur i autorizuari i paditësit, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore dhe konstatimit të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që Gjykata e Apelit ta prish aktvendimin e atakuar dhe lëndën t’ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim.

Përgjigje në ankesë nuk ka paraqitur e paditura.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 196, 208, 209 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa e të autorizuarit të paditësit është e pa afatshme.

Gjykata e Apelit, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, konstatoi se i autorizuari i paditësit aktvendimin e ankimuar, C.nr.77/20, të datës 09.12.2022, e ka pranuar me datën 14.12.2022, ndërsa ankesën kundër aktvendimit e ka dorëzuar në gjykatë me datën 30.12.2022, pas kalimit të afatit 15 ditë për paraqitjen e ankesës. Si datë e fundit për paraqitjen e ankesës ka qenë data 29.12.2022, që do të thotë se ankesa e të autorizuarit të paditësit është paraqitur 1 ditë pas afatit të paraparë ligjor dhe se për të njëjtën nuk ka prova në shkresa të lëndës se është dorëzuar nëpërmjet postës.

Pasi që afati për ankesë sipas aktvendimit të ankimuar ka qenë 15 ditë, nga dita e pranimit të aktvendimit, atëherë rezulton që ankesa është dorëzuar pas skadimit të afatit prej 15 ditësh, për faktin se afati fillon të llogaritet nga data 15.12.2022, dhe kur llogariten 15 ditë, atëherë dita e fundit për parashtrimin e ankesës ka qenë data 29.12.2022 (ditë e enjte). Andaj, në bazë të cekurave dhe duke marrë për bazë se afati për ankesë është afat prekluziv, Gjykata e Apelit vendosi duke u bazuar në nenin 186 paragrafi 2, të LPK-së, sipas të cilit ankesa është e pa afatshme po që se është paraqitur pas skadimit të afatit ligjor për paraqitjen e saj, si dhe nenit 196, të LPK-së, ku është përcaktuar se: *“ankesën e vonuar, jo të plotë, apo të palejueshme, e hedhë poshtë gjykata e shkallës së dytë me aktvendim, po që se nuk e ka bërë një gjë të tillë gjykata e shkallës së parë siç është parashikuar në (nenin 186)”*, andaj, pasi që në rastin konkret gjykata e shkallës së parë nuk e ka vlerësuar afatshmërinë e ankesës dhe të njëjtën nuk e ka hedhur si të pa afatshme, sipas ligjit vendosi gjykata e shkallës së dytë.

Nga sa u tha me lartë, Gjykata e Apelit e Kosovës në kuptim të dispozitës së nenit 208, 209 par.1 pika a) dhe nenit 196 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
Ac.nr.2834/23, me datë 17.05.2024

Kryetar i Kolegjit-Gjyqtari
Liridon Maloku